



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Përkthim A-B

Ngarkesa: 3 kredite, 30 orë (seminare)

Viti akademik/semestri kur zhvillohet: Viti I, Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master në Përkthim teknik –letrar dhe Interpretim /Gjuha Frënge

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Ndryshe nga përkthimi BA drejt gjuhës mbërritëse (shqipese), përkthimi drejt gjuhës burimore nga shqipja drejt gjuhës frënge është një modul bazë që zhvillohet semestrin e parë të studimeve master. Lënda është konceptuar si një studim i thelluar i problematikave (përsosja e të shprehurit drejt gjuhës B) që lindin nga kalimi i mesazhit nga gjuha amtare drejt gjuhës së parë të huaj nëpërmjet përkthimit të teksteve të aktualitetit të fushave të ndryshme të tilla si ajo e ekonomisë, politikës, mjedisit, institucioneve, letrare, etj.

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të strukturojë njohuritë gjuhësore në dy gjuhët dhe ti aktualizojë ato.;Të përcjellë mesazhin me shkrim duke respektuar qëllimet, publikun e synuar si edhe objektivat e autorit, si edhe kriteret gjuhësore të regjistrit të gjuhës nga e cila përkthehet. Të identifikojë elementet socio-kulturore të nënkuptuara në një tekst të shkruar.;Të analizojë presupozimet, të pathënnën, aluzionet, stereotipet, ndërtekstualitetin e një teksti me shkrim. Të përvetësojë mjetet e të kuptuarit dhe të trajtimit të një teksti duke përdorur metodat e analizës duke i orientuar drejt sintezës (të bëjë dallimin mes thelbësore dhe dytësore)

Objektivat specifike lëndore:

Studenti duhet të njohë se si të:

Zotërojë dhe përdorë njohuri gjuhësore teorike dhe praktike në fushën e përkthimit.

Të përftojë njohuri ndërkulturore të dobishme për të kuptuar, analizuar dhe kontekstualizuar veprimtarinë përkthimore.

Të mobilizojë njohuri know how teorike dhe praktike specifike për përkthimin.